

URDHËR
Nr. 3, datë 26.1.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, të kompetencave funksionale si vijon:

a) lëshimin e autorizimeve për përfaqësim ligjor, të Ministrisë së Financave, në proceset gjyqësore ku thirret si palë në gjykim apo si subjekt i interesuar dhe nënshkrimin e akteve procedurale, të tilla si: kërkesëpadi, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi;

b) përcaktimin e numrit të punonjësve që shoqërojnë delegacionet e huaja dhe miratimin e programeve për shërbimet e pritje përcjellje që organizon ministri i Financave;

c) miratimin e kërkesave për kryerjen e orëve shtesë të punës, për punonjësit e strukturës së ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) nënshkrimin e kontratave të punës, si dhe aktet për përfundimin e marrëdhënies së punës, për pozicionet që rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë;

d) kryerjen e të gjitha veprimeve administrative dhe procedurale në funksion të miradministrimit të burimeve njerëzore të sistemit ministror, me përjashtim të atyre që sipas legjislacionit në fuqi u janë ngarkuar organeve kompetente.

2. Delegimin e autorizimit, për dërgim me shërbim jashtë vendit dhe brenda vendit në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, të nëpunësve të Ministrisë së Financave dhe institucioneve të varësisë, të zëvendësministrat të Ministrisë së Financave, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, zëvendësministrat, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave dhe institucionet e varësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete